REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	**11.10.2023**
REFERENCË	
PËR:	**z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan**
Cc:	**z. Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan** **z. Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan**
NGA:	**z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan**
LËNDA:	**Raport i punës – Muaji Shtator 01.09.2023-30.09.2023**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan gjatë muajit Shtator është marrë me përgatitjet teknik– administrative dhe higjieno-sanitare të shkollave dhe materiale të ndryshme shkollore pa të cilat nuk mund të filloj procesi edukativo-arsimor.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Është bërë nënshkrimi i memorandum mirëkuptimit mes Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Kulturës dhe Teach For Kosova me qëllim të zbatimit të dy projekteve:

- ‘’Let Girls Thrive’’ i cili parasheh të krijojë klubin e barazisë gjinore dhe
- ‘’Përmirësimi i qasjes dhe i mundësive për fëmijët e Kosovës’’.

Ka përfunduar ndërtimi i Çerdhës në Shalë.

Instalimi i kamerave të sigurisë në Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure, p.n.f Blinajë.

Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Lipjanit.

Vizita pune në:

- Shfmu “Dy Dëshmorët” në Dobrajë e Madhe
- Shfmu “7 Marsi” në Poturoc,
- Shfmu “Vëllezprit Frashëri” në Lipjan,
- SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan dhe
- SHML Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan.

Është bërë sigurimi i transportit të nxënësve për 15 lloto në relacione të ndryshme duke përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta.

Futja e buxhetit në programin qeveritar **BDMS-së.**

Është bërë furnizimi i të gjitha IEA-ve me:

- Dokumentacion pedagogjik (ditar, libra amë, fletore pune etj) dhe furnizime të zyrës.
- Lëndë djegëse-dru dhe pelet.

Mbajtja e ditës së shkollës në:

- Shfmu "Nezë Bujani" në Bujan dhe
- SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan.

Kërkesë Departamentit të Prokurimit për zhvillim të procedurës së Prokurimit për:

- Transporti i nxënësvë nga fshati Kojskë deri në Shfmu "Drita" Rubovc dhe anasjelltas-kontratë kornizë 2 vjeçare (lloto 6),
- Trasporti i nxënësve në relacionin nga fshatrat Ribar i Vogël dhe Rufc i Vjetër deri në Shfmu "Migjeni" Rufc i Ri dhe anasjelltas-kontratë kornizë 2 vjeçare (lloto 3),
- Instalimi dhe monitorimi i sistemit të alarmit kundër thyerjes –vjedhjes në IEA-kontratë dy vjeçare,
- Shitja e dsa deleve, gjedhave dhe viqave në pronësi të shkollës "Adem Gllavica" në Lipja përmes ankandit dhe
- Renovimi i kulmit në Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve.

Kërkesë MASHT-it dhe Ministrisë për komunitet dhe kthim për renovimin e shkollës fillore në Janjevë.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonia, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

STATISTIKAT

Gjatë muajit Shtator nuk kemi pasur ndonjë statistikë për të paraqitur në raport mujor.

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takim me përfaqësuesit e Forumit të Aftësisë së kufizuar rreth përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat e komunave target,
- Takim me përfaqësuesit e UNICEF-it rreth bashkëpunimit të ndërsjelltë rreth edukimit të fëmijërisë së hershme,
- Takim me policinë e Kosovës në Rajonin e DRP- Prishtinë në lidhje me sigurinë e shkollave (me drejtorat e shkollave të mesme),
- Takim me përfaqësuesit e Teach for Kosova,
- Takime të ndryshme me qytetarë, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin dhe
- Takime të vazhdueshme me drejtorët e shkollave.

SFIDAT

- Zvoglimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe mbylljes së paraleleve të ndara fizik,
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t'i vlerësoj të gjithë në kohë reale dhe
- Nevoja për angzhimin e asistenteve për nxenës me nevoja te veqanta ose realizimi i mundësisë për angazhimin e tepricës së mësuesve që mbesin pa vend pune në pozitën e asistentëve.

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.